

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Basics**

B2

Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 29.06.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

1. Të gjitha elementet e mëposhtme janë shembuj të shërbimeve të ofrimit të sigurisë, përveç:
A. Angazhimeve financiare.
B. Angazhimeve të pajtueshmërisë.
C Angazhimeve të kujdesit të duhur.
D. Angazhimeve për trajnime.
2. Sipas Standardit Pavarësia e Organizatës të IIA-së, cili nga elementet e mëposhtme nuk është pjesë e raportimit administrativ të menaxhimit të organizatës?
A. Administrimi i burimeve njerëzore.
B. Konfirmimi vjetor i pavarësisë organizative të auditimit.
C. Kontabiliteti menaxherial.
D. Politikat dhe procedurat e auditimit.
3. Cila nga të mëposhtmet është unike për vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve të auditimit të brendshëm?
A. Praktikat më të mira.
B. Rikuperimi i kostos.
C. Studimi krahasues.
D. Rezultatet e pritshme.
4. Sipas Standardit të Planifikimit të IIA-së, rreziku rezidual njihet edhe si cila nga të mëposhtmet?
A. Rreziku i auditimit.
B. Rrezik pastër.
C. Rreziku aktual.
D. Rreziku i vetvetishëm.
5. Cila nga këto është e lidhur ngushtë me pranimin e rrezikut?
A. Zbulimi i rrezikut.
B. Parandalimi i rrezikut.
C. Toleranca e rrezikut.
D. Korrigjimi i rrezikut.
6. Për një departament të ri të auditimit të brendshëm është duke u draftuar një statut. Cila nga të mëposhtmet përshkruan më mirë gjendjen e duhur organizative që duhet të përfshihet në statut?
A. Menaxheri i auditimit duhet të raportojë tek Kryeshefi ekzekutiv i organizatës (CEO), por të ketë qasje gjithashtu në bordin e drejtorëve.
B. Menaxheri i auditimit duhet të jetë anëtar i komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve.
C. Menaxheri i auditimit duhet të jetë pjesë e stafit që raporton tek zyrtari kryesor financiar.
D. Menaxheri i auditimit duhet t'i raportojë një nënkryetari administrativ.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

7. Objektivat e angazhimit të këshillimit duhet të jenë në përputhje me të gjitha elementet e mëposhtme, përveç:
- A. Qëllimeve të organizatës.
 - B. Vlerave të organizatës.
 - C. Strategjive të organizatës.
 - D. Objektivave të organizatës.
8. Cila nga veprimet e mëposhtme do të ishte një shkelje e pavarësisë së auditorit?
- A. Vazhdimi i një angazhimi të auditimit në një divizion për të cilin auditori së shpejti do të jetë përgjegjës si rezultat i një promovimi.
 - B. Reduktimi i objektit të auditimit për shkak të kufizimeve buxhetore.
 - C. Pjesëmarrja në një task forcë e cila rekomandon standardet e duhura të kontrolleve për një sistemi të ri të shpërndarjes.
 - D. Rishikimi i një kontrate që është përpiluar nga një agjent blerjeje para nënshkrimit të saj.
9. Zhvillimi i një gjetjeje të auditimit përfshin krahasimin e kushteve me standardin ose kriterin përkatës. Cila nga zgjedhjet e mëposhtme më së miri përfaqëson një standard ose kriter të përshtatshëm për të mbështetur një gjetje?
- A. Një procedurë standarde operative e cilësisë (numri dhe data) për departamentin.
 - B. Një parim i kontrollit të brendshëm kontabël, i cituar dhe kopjuar nga një referencë e kontabilitetit publik.
 - C. Një praktikë e shëndoshë e biznesit, bazuar në njohuritë dhe përvojën e auditorit të brendshëm të marra gjatë shumë angazhimeve të auditimit brenda kompanisë.
 - D. Të gjitha të mësipërme.
10. Kohët e fundit, një ekip i auditimit të brendshëm përfundoi auditimin e pajtueshmërisë së kompanisë me kontratën e saj të qirasë kundrejt politikës së kompanisë për blerje të automobilave. Raporti i auditimit vuri në dukje se bazat për disa vendime për marrje me qira në vend të blerjes së automobilave, nuk janë dokumentuar dhe nuk ishin të auditueshme. Raporti përmbante rekomandimin që menaxhmenti operativ të sigurojë që marrëveshjet e tilla të qirasë të mos ekzekutohen pa dokumentacionin e duhur të bazës për vendimin për marrje me qira në vend të blerjes. Auditorët e brendshëm janë të gatshëm të kryejnë punën pasuese (follow-up) për këtë raport të auditimit. Qëllimi kryesor për kryerjen e rishikimit pasues (follow-up review) është të:
- A. Sigurohet shqyrtimi në kohë i rekomandimeve të auditorit të brendshëm.
 - B. Konstatoni se është ndërmarrë veprimi i duhur për gjetjet e raportuara.
 - C. Lejoj auditorët e brendshëm të vlerësojnë efektivitetin e rekomandimeve të tyre.
 - D. Dokumentoj se çfarë po bën menaxhmenti në përgjigje të raportit të auditimit dhe të mbyll skedarin e auditimit në kohën e duhur.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

11. Standardet e IIA specifikojnë që mbikëqyrja e punës së auditorëve të brendshëm "të kryhet vazhdimisht." Cila nga deklaratat e mëposhtme në lidhje me mbikëqyrjen është e saktë?
- I. Shprehja "vazhdimisht" sugjeron se mbikëqyrja duhet të kryhet gjatë tërë fazave të auditimit: planifikimit, ekzaminimit, vlerësimit, raportimit dhe punës pasuese (follow-up).
 - II. Mbikëqyrja gjithashtu duhet të shtrihet edhe gjatë trajnimit, raportimit kohor dhe kontrollit të shpenzimeve, si dhe çështje administrative të ngjashme.
 - III. Shtrirja dhe natyra e mbikëqyrjes duhet të dokumentohet, mundësisht në letrat e dhura të punës.
- A. Vetëm I.
 - B. I dhe III.
 - C. Vetëm II.
 - D. I, II dhe III.
12. Një auditor i ri është angazhuar për një auditim të operacioneve të menaxhimit të parasë së gatshme të organizatës. Auditori i ri nuk ka njohuri për auditimin e menaxhimit të parasë dhe ky është auditimi i parë i auditorit. Në cilën prej kushteve të mëposhtme, departamenti i auditimit të brendshëm do të jetë në përputhje me standardet lidhur me njohuritë dhe aftësitë?
- A. Auditori i lartë është i aftë në këtë fushë dhe e mbikëqyr nga afër auditorin e ri.
 - B. Auditori i ri e kryen angazhimin dhe e përgatit një raport që rishikohet në detaje nga drejtori i auditimit.
 - C. Nuk është dhënë informacion i mjaftueshëm.
 - D. Asnjë nga të mësipërmet.
13. Një organizatë, ishte në procesin e krijimit të departamentit të ri të auditimit të brendshëm. Kontrolli i brendshëm nuk kishte përvojë të mëparshme me auditorët e brendshëm. Për shkak të mungesës së përvojës, kontrolli i brendshëm e këshilloi departamentin e auditimit të brendshëm të raportonin tek auditorët e jashtëm. Megjithatë, shefi ekzekutiv i ri i auditimit (CAE) do të kishte qasje të lirë tek kontrolli i brendshëm për të raportuar ndonjë gjë të rëndësishme. Kontrolli i brendshëm do të përcjell shqetësimet e shefit ekzekutiv të ri të auditimit tek bord i drejtorëve. Cila nga të mëposhtmet është e vërtetë?
- A. Departamenti i auditimit të brendshëm do të jetë i pavarur, meqenëse shefi ekzekutiv i ri i auditimit ka qasje direkte tek bordi i drejtorëve.
 - B. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk do të jetë i pavarur, për shkak se shefi ekzekutiv i ri i auditimit raporton tek auditorët e jashtëm.
 - C. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk do të jetë i pavarur, meqenëse kontrolli i brendshëm nuk ka përvojë me auditorët e brendshëm.
 - D. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk do të jetë i pavarur, meqenëse kompania nuk e ka specifikuar se kandidatët e departamentit të auditimit të brendshëm duhet të jenë auditorë të brendshëm të certifikuar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

14. Cila nga veprimet e mëposhtme do të ishte shkelje e pavarësisë?
- A. Vazhdimi i një angazhimi të auditimit në një departament për të cilin auditori së shpejti do të jetë përgjegjës si rezultat i një promovimi.
 - B. Zvogëlimi i fushës së auditimit për shkak të kufizimeve buxhetore.
 - C. Pjesëmarrja në një forcë pune e cila rekomandon standarde për kontrollin e një sistemi të ri të shpërndarjes.
 - D. Rishikimi i drafteve të kontratës së agjentit të blerjes para ekzekutimit të blerjes.
15. Një auditor i brendshëm nuk ka arritur të zbulojë një mashtrim të punonjësve gjatë një auditimi. Mos zbulimi ka më shumë gjasa të sugjerojë një shkelje të standardeve të IIA-së, nëse ajo ishte rezultat i një:
- A. Dështimi për të kryer një auditim të detajuar të të gjitha transaksioneve në zonë.
 - B. Përcaktimi se çdo mashtrim i mundshëm në atë fushë nuk do të përfshinte një shumë materiale.
 - C. Përcaktimi se kostoja e shtrirjes së procedurave të auditimit në atë fushë do të tejkalonte përfitimet e mundshme.
 - D. Supozimi se kontrollat e brendshme në zonë ishin adekuate dhe efektive.
16. Sipas Standardeve të IIA-së, pavarësia e auditorëve të brendshëm arrihet përmes:
- A. Stafit dhe mbikëqyrjes.
 - B. Edukimit të vazhdueshëm dhe kujdesit të duhur profesional.
 - C. Marrëdhënieve njerëzore dhe komunikimeve.
 - D. Statusit organizativ dhe objektivitetit.
17. Sipas Standardeve të IIA, qëllimet e departamentit të auditimit të brendshëm duhet të specifikojnë:
- A. Planet e punës së auditimit dhe aktivitetet që duhet të auditohen.
 - B. Politikat dhe procedurat për të udhëhequr stafin e auditimit.
 - C. Kriteret e matjes dhe datat e synuara për përfundim.
 - D. Planet e personelit dhe buxhetet financiare.
18. Menaxheri i auditimit duhet të përcaktojë se si një organizatë mund të ndahet në aktivitete audituese. Cila nga të mëposhtmet është një aktivitet auditues?
- A. Një procedurë.
 - B. Një sistem.
 - C. Një llogari.
 - D. Të gjitha të mësipërmet.
19. Gjetjet e auditimit shpesh dalin nga një proces i krahasimit të asaj se si duhet të ishte me atë se si është. Gjetjet bazohen në atributet e kriterëve, gjendjes dhe shkakut si dhe efektit. Nga përshkrimet e mëposhtme, cila përshkruan më së miri efektin e gjetjes së auditimit?
- A. Arsyeja për ndryshimin midis kushteve të pritura dhe atyre aktuale.
 - B. Dëshmitë faktike të gjetura gjatë kohës së ekzaminimit.
 - C. Rreziku ose ekspozimi i hasur për shkak të gjendjes.
 - D. Standardet, masat ose pritjet e përdorura për të bërë vlerësimin.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

20. Menaxheri i auditimit është përgjegjës për krijimin e një programi për zhvillimin e burimeve njerëzore të departamentit të auditimit të brendshëm. Sipas standardeve të IIA-së, ky program duhet të përfshijë:
- A. Mundësitë e edukimit të vazhdueshëm dhe vlerësimet e performancës.
 - B. Këshillimin dhe një rrugë karriere të themeluar.
 - C. Një plan trajnimi të themeluar dhe një statut.
 - D. Përshkrimet e punës dhe rritja e pagës konkurruese.
21. Procedurat organizative i lejojnë punonjësve të parashikojnë problemet e mundshme. Ky lloj i kontrolleve njihet si::
- A. Kontroll reagues (feedback).
 - B. Kontroll strategjik.
 - C. Kontroll parandalues.
 - D. Vlerësimi i performancës.
22. Gjatë vlerësimit të kontrolleve të aplikacioneve, cili nga kontrollet e mëposhtme të kontrollit të hyrjes ose kontrollet e redaktimit ka më shumë gjasa të përdoret për të zbuluar një gabim të futjes së të dhënave në fushën e numrit të llogarisë së klientit?
- A. Kontrolli i limitit.
 - B. Kontrolli i vlefshmërisë.
 - C. Kontrolli i përgjithshëm.
 - D. Totalët serike.
23. Për shkak të cenueshmërisë së saj ndaj mashtimit, departamenti i besimit të një banke kërkoi që një zyrtar tjetër përveç zyrtarit të besimit të verifikojë urdhrat e shpërndarjes së të ardhurave dhe të nënshkruajë çeqet e pagesave. Cili lloj kontrolli karakterizohet nga një ndarje e tillë e detyrave?
- A. Hyrës.
 - B. Auditimit.
 - C. Korrigjues.
 - D. Operativ.
24. Kontrollet mund të klasifikohen sipas funksionit që ata synojnë të kryejnë; për shembull, për të zbuluar ndodhjen e një ngjarjeje të padëshiruar (detektivë), për të shmangur ndodhjen e një ngjarjeje të padëshiruar (parandaluese), ose për të siguruar ndodhjen e një ngjarjeje të dëshirueshme (direktive). Cila nga këto është një kontroll direktivë?
- A. Kryerja e harmonizimit bankar mujor.
 - B. Kërkimi i nënshkrimeve të dyfishta për të gjitha pagesat mbi një sasi të caktuar eurosh.
 - C. Regjistrimi i çdo transaksioni në ditën kur ndodh.
 - D. Të kërkojë që të gjithë anëtarët e departamentit të auditimit të brendshëm të jenë Auditorë të Brendshëm të Çertifikuar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

25. Cila nga të mëposhtmet është një lidhje efektive midis nivelit të rrezikut dhe nivelit të kontrollit të brendshëm?

- A. Rrezik i ulët dhe kontrole të forta.
- B. Rrezik i lartë dhe kontrole të dobëta.
- C. Rrezik i mesëm dhe kontrole të dobëta.
- D. Rrezik i lartë dhe kontrole të forta.

26. Zakonisht vendimet e kontrollit nuk përfshijnë:

- A. Cilat masa duhet të imponohen.
- B. Si të vlerësojmë performancën.
- C. Çfarë lloj dënimesh duhet të imponohen.
- D. Çfarë lloj stimulsh të përdoren.

27. Sipas raportit të COSO, niveli i pragut për një "gjendje raportuese" është:

- A. Më e lartë se ajo e një dobësie materiale.
- B. Një matës për përcaktimin nëse sistemi i kontrollit të brendshëm është efektiv.
- C. Më e ulët se ajo e një dobësie materiale.
- D. Një matës për përcaktimin nëse sistemi i kontrollit të brendshëm është i paefektshëm.

28. Një menaxher i prodhimit në një ndërmarrje të mesme prodhuese filloi të porosit lëndë të parë të tepërta dhe t'i dorëzoj tek një ndërmarrje e shitjes me shumicë që ai drejton si një biznes anësor. Ai falsifikonte dokumentet e pranimit të mallit dhe miratonte faturat për pagesë. Cila nga procedurat vijuese të auditimit ka më shumë gjasa të zbulojë këtë mashtrim?

- A. Merrni një mostër të daljeve të parasë së gatshme; krahasoni porositë e blerjes, raportet e pranimit, faturat dhe kopjet e kontrollit.
- B. Merrni një mostër dhe konfirmoni shumën e blerë, çmimin e blerjes dhe datën e dërgesës së furnitorit.
- C. Vëzhgoni dokumentin e pranimit dhe numëroni materialin e marrë; krahasoni llogaritjet e tua me raportet e marrura dhe të plotësuara nga personeli i pranimit.
- D. Përgatitni analiza analitike, krahasimi i prodhimit, materialeve të blera dhe niveleve të stokeve të materialeve të papërpunuara, si dhe hetimi i diferencave.

29. Në mënyrë që auditorët e brendshëm të jenë në gjendje të njohin mashtrimin e mundshëm, ata duhet të jenë të vetëdijshëm për karakteristikat themelore të mashtrimit. Cila nga të mëposhtmet nuk është një karakteristikë e mashtrimit?

- A. Mashtrimi i qëllimshëm.
- B. Marrja e përfitimit të padrejtë ose të pandershëm.
- C. Kryerja e verprimit në dobi ose në dëm të organizatës.
- D. Neglizhenca nga ana e menaxhmentit ekzekutiv.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

30. Cila nga të mëposhtmet është një tregues i mashtrimit të mundshëm të raportimit financiar që kryhet nga menaxhmenti i një ndërmarrje prodhuese?

- A. Një analizë e trendit zbulon (1) rritjet e shitjeve prej 50% dhe (2) kostot e mallrave të shitura rriten me 25%.
- B. Një analizë raporti zbulon (1) shitjet prej 50 milion dollarë dhe (2) kosto të mallrave të shitura prej 25 milion dollarë.
- C. Një analizë ndërsektoriale e deklaratave të zakonshme të madhësisë nxjerr në pah: (1) Raporti i ndërmarrjes për koston e mallrave të shitura në raport me shitjet është 0.4 dhe (2) raporti mesatar i industrisë së kostos së mallrave të shitura në raport me shitjet është 0.5.
- D. Një analizë ndërsektoriale e deklaratave të zakonshme të madhësisë nxjerr në pah: (1) Raporti i ndërmarrjes për koston e mallrave të shitura në raport me shitjet është 0.5 dhe (2) raporti mesatar i industrisë së kostos së mallrave të shitura në raport me shitjet është 0.4.

31. Auditorët janë këshilluar të shikojnë flamujt e kuq për të përcaktuar nëse menaxhmenti është i përfshirë në një mashtrim. Cila nga të mëposhtmet nuk paraqet vështirësi në përdorimin e flamujve të kuq si tregues mashtrimi?

- A. Shumë flamuj të kuq të përbashkët gjithashtu lidhen me situata ku nuk ekziston mashtrimi.
- B. Disa flamuj të kuq janë të vështirë të përcaktohen ose të vlerësohen.
- C. Informacioni i flamurit të kuq nuk mblidhet si një pjesë normale e angazhimit të auditimit.
- D. Literatura e flamujve të kuq nuk është themeluar mjaft mirë që të ketë një ndikim pozitiv në auditim.

32. Departamenti i auditimit të brendshëm është caktuar për të kryer një auditim të një departamenti. Në bazë të rishikimit të mjedisit, auditori u njoftua me sa vijon në lidhje me politikat e menaxhimit:

Politika e kompanisë është që të promovojë menjëherë menaxherët e departamenteve që tregojnë sukses të rëndësishëm. Kështu që, menaxherët e suksesshëm rrallë qëndrojnë në një departament për më shumë se tre vjet.

Një pjesë e konsiderueshme e kompensimit të menaxherëve të departamenteve vjen në formën e shpërblimeve bazuar në përfitueshmërinë e departamentit.

Departamenti u identifikua nga menaxhmenti i lartë si një mundësi kthyesë. Departamenti është duke u rritur por nuk është planifikuar për një auditim të plotë, këtë vit, nga auditorët e jashtëm. Departamenti është rritur rreth 7% në vit gjatë tre viteve të fundit dhe përdor një sistem të kostos standarde.

Gjatë rishikimit të ndërmjetëm, auditori vë në dukje ndryshimet e mëposhtme në të dhënat financiare në krahasim me vitin paraprak:

- Shitjet janë rritur me 10%.
- Kostoja e mallrave të shitura është rritur me 2%.
- Inventari është rritur me 15%.
- Fitimi neto i departamentit është rritur me 8%.

Cila nga pikat e mëposhtme mund të e paralajmërojë auditorin për mundësinë e mashtrimit në departament?

- A. Departamenti nuk është planifikuar për një auditim të jashtëm këtë vit.
- B. Shitjet janë rritur me 10%.
- C. Një pjesë e rëndësishme e kompensimit të menaxhementit është e lidhur drejtpërdrejt me fitimin neto të departamentit.
- D. Të gjitha të mësipërmet.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

33. Roni dhe Gjoni kishin njohur njëri-tjetrin për shumë vite. Ata ishin bërë miq të mirë që në kolegji, ku të dy diplomuan në kontabilitet. Pas diplomimit, Roni mori në mbikëqyrje biznesin e familjes nga babai i tij. Familja e tij kishte një biznes ushqimor për disa breza. Kur Gjoni kishte vështirësi në gjetjen e një pune, Roni i ofroi atij punë në dyqanin e familjes. Gjoni dëshmoi të qenit një punonjës shumë i aftë. Ndërsa Gjoni demonstroi aftësitë e tij, Roni filloi të delegonte gjithnjë e më shumë përgjegjësi ndaj tij. Pas një periudhe kohore, Gjoni po kryente të gjitha autorizimet dhe funksionet e përgjithshme të kontabilitetit për çeqet, paratë, stoqet, dokumentet, regjistrimet dhe harmonizimet e deklaratave bankare.

(I) Gjoni u konsiderua plotësisht i besueshëm dhe i menaxhonte të gjitha funksionet financiare. Askush nuk e kontrollonte punën e tij. Roni vendosi të zgjerojë biznesin dhe hapi disa dyqane të reja.

(II) Roni trajtonte gjithmonë problemet më urgjente ... profesorët e tij të kolegjit e kishin quajtur "menaxher i krizës". Gjoni e ndihmonte me problemet kur punët e tjera të tij i lejonin kohë. Ndonëse ishte i suksesshëm në punë, Gjoni kishte vështirësi me problemet financiare personale.

(III) Në fillim, shumat që Gjoni vodhi ishin të vogla. Ai as nuk u shqetësua për të bërë bilancin e llogarive. Por Gjoni u bë lakmitar. "Sa e lehtë është të marrësh para," tha ai. Ai ndjeu se ai ishte një anëtar kritik i ekipit të biznesit, dhe se ai kontribuoi shumë më shumë në suksesin e kompanisë sesa ishte përfaqësuar nga paga e tij.

(IV) Do të duheshin dy ose tre vetë për të më zëvendësuar, ai shpesh mendonte për vetveten. Ndërsa shumat bëheshin çdo herë e më të mëdha, ai bëri bilancin e llogarive.

(V) Për shkak të këtyre aktiviteteve, Gjoni ishte në gjendje të blente një makinë të shtrenjtë dhe të merrte familjen e tij në disa udhëtime çdo vit.

(VI) Ai gjithashtu u bashkua me një klub të shtrenjtë të vendit. Gjithsesi, gjërat ndryshonin në shtëpi. Familja e Gjoni vuri re se shpesh ai ishte argumentues dhe në raste të tjera shumë në depresion.

(VII) Mashtrimi vazhdoi për gjashtë vjet. Çdo vit biznesi performoi gjithnjë e më keq. Në vitin e kaluar dyqanet humbën mbi 200,000€. Banka e Ronit kërkoi një auditim. Gjoni u rrëfye kur mendoi se auditorët kishin zbuluar përvetësimet e tij.

Kur diskutohen mashtrimet, shpesh janë identifikuar presionet, mundësitë dhe racionalizimet që shkaktojnë/lejojnë një keqbërës që të kryejë mashtrimin. Gjithashtu janë studiuar simptomat e mashtrimit. Identifikoni faktorët e numëruar dhe të nënvizuar (nga skenari) si një nga simptomat, presionet, mundësitë ose racionalizimet e dhëna. **Numri IV, " dhe se ai kontribuoi shumë më tepër ...,"** është një shembull i një:

A. Racionalizimi.

B. Simptome sjellje.

C. Presioni të situatës.

D. Simptome fizike.

34. Cila nga të mëposhtmet përshkruan më së miri disavantazhin më të madh të përdorimit të një pyetësoi dhe jo të një diagrami rrjedhës (flowchart) për të vlerësuar kontrollet e brendshme?

A. Pyetësoret zakonisht marrin më shumë kohë për t'u përgatitur dhe janë më të pavolitshëm.

B. Përgjigjet nuk alarmojnë (tregojnë, shënojnë) në mënyrë efikase dobësitë e mundshme të kontrollit të brendshëm.

C. Është e vështirë për auditorët të zhvillojnë ose të sigurojnë pyetësorë që janë të përshtatshëm për shumicën e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

D. Auditorët mund të plotësojnë pyetësorët pa i kuptuar në të vërtetë operacionet e përgjithshme të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

35. Menaxhmenti i një kompanie të sigurimit të pronave dhe viktimave është i shqetësuar për efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të përpunimit të kërkesave të rimbursimit. Ka dy shqetësime kryesore: (1) Janë paguar disa kërkesa përf rimbursim që nuk duhet të paguhen ose paguhen në shuma që tejkalojnë politikën; dhe (2) shumë pretendues nuk paguhen në kohën e duhur. Gjatë përgatitjes për një auditim të fushës, auditori i brendshëm vendos të kryejë një rishikim të ndërmjetëm për të mbledhur më shumë informacione rreth natyrës së përpunimit të kërkesave të rimbursimit dhe problemeve të mundshme.

Auditori përdori një pyetësor gjatë intervistave për të mbledhur informacion rreth natyrës së përpunimit të kërkesave të rimbursimit. Për fat të keq, pyetësi nuk mbulonte një numër të informatave të ofruara nga personi i intervistuar. Rrjedhimisht, auditori nuk ka dokumentuar problemet potenciale për hetime të mëtejshme të auditimit. Mangësia primare me këtë proces është se:

- A. Auditori dështoi në vlerësimin e rëndësisë së informacionit të ofruar.
- B. Përdorimi i një pyetësi në një situatë ku duhej përdorur një intervistë e strukturuar.
- C. Pyetësit nuk lejojnë mundësi për të dokumentuar të dhëna të tjera.
- D. Të gjitha të mësipërme.

36. Një auditor po shqyrton zhvillimin e një pyetësi për të hulumtuar qëndrimin e punonjësve ndaj procedurave të kontrollit. Cila nga këto paraqet kritere që nuk duhet të merren parasysh në hartimin e pyetësit?

- A. Pyetjet duhet të formulohen për të siguruar një interpretim të vlefshëm nga të anketuarit.
- B. Pyetjet duhet të formulohen në mënyrë të besueshme në mënyrë që të matin atë që do të duhej të masin.
- C. Pyetësi duhet të jetë i shkurtër për të rritur shkallën e përgjigjes.
- D. Pyetjet duhet të formulohen në mënyrë të tillë që një përgjigje "jo" të tregojë një problem.

37. Auditimi aktual i aktiviteteve të pagesës së parasë së gatshme tregon një numër të konsiderueshëm gabimesh të bëra gjatë procesit të pagimit të llogarive të pagueshme që kanë rezultuar në humbjen e zbritjeve dhe një numër të jashtëzakonshëm rregullimesh dhe kredit notave. Deri më sot, shkaqet nuk janë identifikuar plotësisht për të gjitha llojet e gabimeve të vërejtura. Mënyra më e përshtatshme e veprimit që auditori duhet të marrë në lidhje me këto probleme është të:

- A. Intervistoj zyrtarët e llogarive të pagueshme dhe ata që janë të përfshirë në përpunimin e këtyre transaksioneve.
- B. Zgjeroj madhësitë e mostrës për veçoritë e testuara tashmë në transaksionet e regjistruara për llogaritë e pagueshme dhe blerjet.
- C. Përqendrohet në kërkesat e programit të auditimit për testimin e pagesave të parave të gatshme për të zbuluar ndonjë informacion të lidhur me ato teste.
- D. Përshkruaj problemet e lidhura me transaksionet e identifikuar deri më tani në një raport të veçantë për menaxhmentin pa shprehur ndonjë shkak apo përfundim të auditorit për situatën.

38. Gjatë përdorimit të mostrimit, devijimi standard përfaqëson një masë të:

- A. Shkallës së pritur e gabimit.
- B. Nivelit të besimit të dëshiruar.
- C. Shkallës së ndryshueshmërisë së të dhënave.
- D. Shtrirjes së saktësisë së arritur.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

39. Duke përdorur rezultatet e mëposhtme nga një shembull i variablave, llogaritni gabimin standard të mesatares.

Madhësia e popullsisë	= 10,000
Madhësia e mostrës	= 144
Mostra e devijimit standard	= 24.00€
Niveli i besimit	= 90% ($Z=1.65$)
Mesatarja	= 84.00€

- A. 60.00€.
- B. 7.00€.
- C. 2.30€.
- D. 2.00€.

40. Auditori është i shqetësuar se një program kompjuterik nuk është duke llogaritur siç duhet sasinë e mallrave që do t'i shtohen dërgesave të mallrave të porositura përmes katalogut. Menaxhmenti konsideron që ndodhja e ndonjë gabimi të kostove të mallrave të transportuara të jetë kritik. Auditori po konsideron përdorimin e teknikave të mostrimit për të shqyrtuar ngarkesat e mallrave të transportuara në faturat për konsumatorët ose përdorimin e mjeteve kompjuterike të auditimit. Cila nga metodat e mëposhtme të marrjes së mostrave apo auditimit do të siguronte sigurinë më të madhe në lidhje me korrektësinë e llogaritjeve të ngarkesës së mallrave të transportuara në kohën e tanishme?

- A. Përdorni marrjen e mostrave të zbulimit duke përzgjedhur transaksione nga faturat, të cilat duhet t'i shtohen ngarkesave të mallrave të transportuara.
- B. Përdorni të dhënat e testimit ose simulimin paralel për të testuar aplikacionin kompjuterik.
- C. Përdorni vlerësimin e ndryshimeve duke përzgjedhur transaksionet nga faturat, të cilat duhet t'i shtohen ngarkesave të mallrave të transportuara.
- D. Përdorni softuer të përgjithësuar të auditimit për të zgjedhur një mostër të njëjësive monetare të faturave që janë faturuar tek konsumatorët.

41. Auditorët e brendshëm përdorin konceptin e saktësisë në kontekstin e marrjes së mostrave të auditimit. Në këtë kontekst, përpikëria është:

- A. Një karakteristikë e popullatës së poseduar dhe nuk është nën kontrollin e drejtpërdrejtë të auditorit.
- B. Një masë e saktësisë me të cilën është krijuar një vlerësim i mostrës. Preciziteti i dëshiruar duhet të krijohet përpara marrjes dhe vlerësimit të mostrës.
- C. Vlerësohet në mënyrë të pavarur nga besueshmëria në një mostër të caktuar.
- D. E rëndësishme për vlerësimin e mostrave të variablave, por jo atributet e mostrave.

42. Një mostër prej 100 artikujsh është marrë nga një popullatë prej 5000 artikujsh. Vlera mesatare ishte 200€ dhe devijimi standard ishte 30€. Intervali i llogaritur i besimit për një nivel të besueshmërisë prej 95% ($Z = 1.96$) është:

- A. 970,600€ në 1,029,400€.
- B. 706,000€ në 1,294,000€.
- C. 996,733€ në 1,003,267€.
- D. 997,060€ në 1,002,940€.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

43. Cila nga deklaratat e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me dy mostra të rastësishme të nxjerrura në të njëjtën mënyrë nga e njëjta popullatë, njëra nga madhësia 30 dhe njëra nga madhësia 300?

- A. Të dy mostrat do të kishin të njëjtën vlerë të pritur.
- B. Mostra më e madhe ka më shumë gjasa të prodhojë një masë më të madhe të mostrës.
- C. Mostra më e vogël do të ketë një interval më të vogël të besueshmërisë prej 95% për mesataren.
- D. Mostra më e vogël do të prodhojë mesatarisht një vlerësim më të ulët të variancës së popullsisë.

44. Ju duhet të auditoni afatet kohore të pagesës së faturave ndaj furnitorëve bazuar në një mostër përfaqësuese të kontrolleve të shkruara. Popullata e mostrës përbëhet nga gjithsej 967 çeqe të paranumëruara rradhazi që janë lëshuar për llogaritë e pagueshme. Nëse e dini që 40% e çeqeve i janë lëshuar një furnitori të vetëm, i cili ofroi zbritje të jashtëzakonshme në para të gatshme, metoda më e përshtatshme e marrjes së mostrave do të ishte:

- A. Marrja e mostrave të grumbullimit.
- B. Marrja e mostrave në intervale.
- C. Marrja e mostrave të thjeshta.
- D. Mostrat e shtresëzuara.

45. Një auditor i brendshëm që planifikon një mostër të veçorive nga një numër i madh i faturave duhet të vlerësojë gabimin e tolerueshëm. Cili faktor i listuar më poshtë është më i rëndësishëm që auditori duhet të marrë në konsideratë?

- A. Objektivi i auditimit.
- B. Madhësia e popullsisë.
- C. Niveli i dëshiruar i besimit.
- D. Varianca e popullatës.

46. Një auditor i brendshëm është i interesuar në saktësinë e procesimit të sistemit të përpunimit të faturave të shitjeve. Shuma monetare e faturave individuale është shumë e ndryshueshme. Auditori i brendshëm ka arsye të forta për të besuar se shkalla e gabimit në procesimin e faturave është midis 3% dhe 10%, por nuk ka idenë e madhësisë monetare të gabimeve. Gjatë vlerësimit se cilën qasje specifike për marrjen e mostrave të ndryshoreve të përdorim, auditori i brendshëm duhet të jetë i vetëdijshëm se:

- A. Meqenëse madhësia e gabimit është e pasigurtë, një mesatare e shtresëzuar për vlerësuesin e njësisë do të performojë keq në këtë rast.
- B. Me normat e gabimeve në këtë varg, ka pak përparësi për të shtresëzuar popullatën.
- C. Ose një vlerësues i ndryshimeve ose një koeficient i ndryshimeve do të jetë më efikas se sa një vlerësues i mesatares për njësi i shtresëzuar në këtë rast.
- D. As një vlerësues e as një koeficient i ndryshimeve është praktik në këtë rast nëse nuk ekziston një vlerë e auditimit dhe një vlerë libri për çdo artikull në popullatë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

47. Çfarë efekti ka një rritje në devijimin standard në madhësinë e kërkuar të mostrave të vlerësimit mesatar për njësi dhe mostrimit të njësisë së dollarit? Supozoni të mos ketë asnjë ndryshim në asnjë nga karakteristikat e tjera të popullatës dhe se nuk ka ndryshim në saktësinë dhe besimin e dëshiruar.

	I	II	III	IV
Vlerësimi mesatar për njësi	Zvogëlimi i madhësisë së mostrës	Nuk ka ndryshim në madhësinë e mostrës	Rritja e madhësisë së mostrës	Nuk ka ndryshim në madhësinë e mostrës
Marrja e mostrës së dollarit	Nuk ka ndryshim në madhësinë e mostrës	Zvogëlimi i madhësisë së mostrës	Nuk ka ndryshim në madhësinë e mostrës	Rritja e madhësisë së mostrës

- A. I.
- B. II.
- C. III.**
- D. IV.

48. Mostrat e njësisë së dollarit nuk janë efikase nëse:

- A. Saldot e kompjuterizuara të llogarive janë duke u audituar.
- B. Duhet të bëhen konkluzione statistikore.
- C. Objektivi i auditimit është i orientuar në nënvlerësime.**
- D. Llogaria përmban një numër të madh transaksionesh.

49. Cila nga të mëposhtmet siguron dëshmi shtesë?

- A. Dëshmia përfundimtare.
- B. Dëshmia direkte.
- C. Dëshmia plotësuese.**
- D. Dëshmia sekondare.

50. Një punonjës i kontabilitetit ka zhvilluar një skemë për të futur faturat mashtruese për furnitorët që nuk ekzistojnë (fiktiv). Të gjitha pagesat janë dërguar në të njëjtën adresë. Auditori dyshon për një mashtrim të mundshëm. Teknika më efektive e auditimit kompjuterik për të hetuar mashtrimin do të ishte:

- A. Përdorni të dhënat e testimit për shitësit të shumtë dhe heto rezultatet e papritura.
- B. Kryen një auditim të plotë të ndryshimeve të programeve kompjuterike.
- C. Përdorimi i softuerit të përgjithësuar të auditimit për të krahasuar adresat nëpër skedarë të shumëfishtë dhe për të shtypur dublikatat për hetim.**
- D. Teston kontrollat e aplikacionit përmes një strukture testimi të integruar dhe heton rezultatet e papritura.